V E N D I M
Nr. 644, datë 12.12.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400/11KV, NË ZEMBLAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 400/110 kv, në Zemblak, Korçë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH, sh.a.-së, Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 34 462 010 (tridhjet e katër milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dhjetë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i KESH, sh.a.-së, Tiranë, zëri "Kosto lokale për shpronësime".

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 171 500 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë dhe të jetë në ngarkim të KESH, sh.a.-së, kërkuesit për shpronësim.

6. Shpronësimi të fillojë brenda vitit 2002 dhe të përfundojë brenda tremujorit të parë të vitit 2003.

7. Punimet për ndërtimin e këtij nënstacioni të fillojnë brenda vitit 2002 dhe të përfundojnë në dhjetor të vitit 2003.

8. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH, sh.a.-ja, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Qarku KORÇË

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 400/110 KV i ZEMBLAKUT KORÇË

Lloji i pasurisë së paluajtshme : **Tokë bujqësore**

Pronarët, pozicioni kadastral, sipërfaqet që do të shpronësohen dhe vlera e kompesimit

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. pasurisë	Sipërfaqja e N/Stacionit m/2	Sipërfaqja Shtyllë m/2	Sipërfaqia Rrugë m/2	Sipërfaqja Përgjithshme m/2	Çmimi lekë/m2	Vlera e kompesimit në lekë
1.	Isuf	Ramadan	Bujari	112/11	57.64			57.64	1000	57.640
2.	Nikolla	Njazi	Bujari	112/9	522.54			522.54	1000	522.540
3.	Resmi	Njazi	Bujari	112/8	1060.56		272.02	1332.58	1000	1.332.580
4.	Natasha Mihali Vasil	Njazi Kosta Kosta	Karamika Karamika Karamika	112/7	182.45	51.11	100.75	334.31	1000	334.310
5.	Sotir	Njazi	Bujari	112/6		48.89	3.63	52.52	1000	52.520
6.	Myfterem	Njazi	Bujari	112/5		44.32		44.32	1000	44.320
7.	Gezim	Halit	Mullalli	112/12	910.61			910.61	1000	910.610
8.	Fatbardh	Halit	Mullalli	112/13	279.00			279.00	1000	279.000
9.	Azem	Mahmut	Mullalli	112/14	721.51		78.25	799.76	1000	799.760
10.	Nexhat	Servet	Mullalli	112/15		55.68	11.14	66.82	1000	66.820
11.	Florenc	Islam	Kulla	112/18	1313.74	30.19	57.33	1401.26	1000	1.401.260
12.	Meleq	Muarrem	Bujari	112/19	1265.6	69.81	49.95	1385.36	1000	1.385.360
13.	Xhevit	Muarem	Kulla	112/20	2762.19		100.76	2862.95	1000	2.862.950
14.	Vaide	Selim	Bujari	112/21	2015.35		59.73	2075.08	1000	2.075.080
15.	Haxhi	Demir	Kulla	112/22	2404.78		68.15	2472.93	1000	2.472.930
16.	Inajet	Bexhet	Kulla	112/23	3511.87		92.99	3604.86	1000	3.604.860
17.	Myzafer	Refik	Kulla	112/24	3507.12		100.15	3607.27	1000	3.607.270
18.	Nexhat	Hamit	Kulla	112/25	3957.5		114.63	4072.13	1000	4.072.130
19.	Avni	Demirali	Shaholli	112/26	3110.57		98.69	3209.26	1000	3.209.260
20.	Syria	Demirali	Shaholli	112/27	1966.94		78.71	2045.65	1000	2.045.650
21.	Arif	Refik	Kulla	112/28	1996.14		153.13	2149.27	1000	2.149.270
22.	Sotiraq	Rahmi	Kulla	112/29	858.35			858.35	1000	858.350
23.	Edmont	Abeli	Kulla	112/30	317.54			317.54	1000	317.540
	SHUMA				**32722.00**	**300.00**	**1440.01**	**34462.01**		**34 . 462. 010**

Shënim : Mbyllet me numrin rendor 23 (njëzet e tre)

Vlera totale e kompesimit të pronarëve 34.462.010 (tridhjetëekatërmilionekatërqindegjashtëdhjetëedymijëedhjetë) lekë.
Shpenzime proceduriale (publikim,kancelari,shpërblim) 171.500 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë
Vlera e përgjithshme e shpronësimit 34.633.510 (tridhjetëekatërmilionegjashtëqindetridhjetëetremijëepesëqindedhjetë)lekë.